



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 5 lidhur me nenin 7, pika 3, të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012", nenit 4, lidhur me nenin 5, të Rregullores (QRK), Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 27.02.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 JEPET PËLQIMI- për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5, (pesë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës parcela si më poshtë:

1.2 Parcela, kadastrale, me numër **P-72116046-02785-1**, sipas certifikatës Nr.450-2019, të datës 07.02.2019 me sipërfaqe prej; **39156m²** nga sipërfaqja e përgjithshme prej; **502304m²** vendi i quajtur "**Shirok**", zona kadastrale Suharekë, pasurisë shoqërore në emër të Kuvendit Komunal e Suharekë, me destinim sipas vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-16-7254 të datës 30.06.2015, është caktuar lokacion për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012" dhe të Rregullores (QRK) Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008", nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-14946
Më datë 28.02.2019

